REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 7, datë 21/03/2005

"PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.5, DT.27/02/2003 "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE"

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 (gërma ç), Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.5, dt.27/02/2003 "Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore" dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Pika 2 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.5, dt.27/02/2003, të riformulohet si vijon:

"Të miratojë strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore me një numër prej 97 punonjësish, sipas Aneksit Nr.1 bashkëngjitur këtij Vendimi"

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, për zbatimin e këtij Vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI